



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:234684

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05491394

C.nr.747/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtares Elvira Emini, si gjyqtare individuale, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F. J. nga fsh. B. K. Lipjan, përfaqësuar nga Petrit Lladrovci av. me seli në Prishtinë, kundër të paditurit B. D. nga fshati M.K. Lipjan, me objekt të çështjes ndryshimi i aktgjykimit për kontaktin me fëmijët, jashtë seance, me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e paditëses F. J. nga fsh. B. K. Lipjan, përfaqësuar nga Petrit Lladrovci av. me seli në Prishtinë, kundër të paditurit B. D. nga fshati M. K. Lipjan, me objekt të çështjes ndryshimi i aktgjykimit për kontaktin me fëmijët, në këtë çështje juridike kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit, pranë kësaj gjykate me dt.01.11.2023, ka parashtruar kërkesë kundër të paditurit, me objekt kontesti ndryshimi i aktgjykimit për kontaktin me fëmijët.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të kërkesës së paditëses ka vërejtur se në rastin konkret bëhet fjalë për padi kundër të paditurit, e jo për kërkesë siq e ka paraqitur pala paditëse. Kjo për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me ndryshim të një aktgjykimi të plotfuqishëm mbi kontaktin me fëmijët e mitur.

Për këtë arsye gjykata duke marrë parasysh faktin se e njëjta nuk i përmban konditat konform nenit 253 të LPK-së të të veprohet sipas saj, me aktvendimin e dt. 14.11.2023, kërkesën e paditëses ia ka kthyer në plotësim dhe rregullim të autorizuarit të saj, në kuptim të dispozitës së nenit 99 lidhur me nenin 102 të LPK-së. Ashtu që paditësen e ka detyruar në drejtim të precizimit të padisë, duke e rregulluar padinë, petitumin e padisë dhe duke e përcaktuar qartë kërkesëpadinë, në afatin prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në të kundërtën padia e paditëses e emërtuar si “kërkesë”do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësja respektivisht i autorizuari i saj nuk i është përmbajtur aktvendimit të marrë nga kjo gjykatë me dt.14.11.2023, edhe përkundër faktit se nga shkresat e lëndës vërtetohet se i autorizuari i paditëses e ka pranuar aktvendimin e gjykatës me datën 08.03.2024.

Në bazë të nenit 102.3 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet se “do të konsiderohet e tërhequr parashtrësja po qe se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qofte se kthehet e pa korrigjuar, gjegjësisht e pa plotësuar do të hedhet poshtë”.

Gjykata vlerëson se të autorizuarit të paditëses i është dorëzuar aktvendimi konform nenit 112 të LPK-së, dhe meqenëse i njëjti nuk kanë vepruar brenda afatit ligjor të dhënë nga gjykata, respektivisht nuk e ka plotësuar padinë, sipas aktvendimit të lartshënuar, andaj në pajtim me nenin 102.3 të LPK-së, gjykata padinë e paditëses e konsideroi të tërhequr.

Gjyqtarja e çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 102.3 dhe 387 pika c të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMEORE NË PRISHTINË -DEGA NE LIPJAN

**Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.747/23 me dt. 12.03.2024.**

G J Y Q T A R J A
Elvira Emini

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:234684
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05491394